



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.845/5 prot.

Datë 21.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 520/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.04.2026 u shqyrtua ankesa me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Syla” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-76447-02-17-2026, me objekt: “*Blerje Karburanti për vitin 2026*”, me fond limit 7,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Has, me adresë: Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, Qyteti Krumë

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Syla” SHPK me NUIS K36306915E dhe adresë: Lagjja Didaj, Rruga Nacionale Krume-Kukes Km1, Zona Kadastrale Nr.2282, Nr.Pasurie 129/1, Has

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për*

*organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.02.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-76447-02-17-2026, me objekt: “Blerje Karburanti për vitin 2026”, me fond limit 7,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

II.2. Në datën 09.03.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “Syla” SHPK skualifikuar
2. “Vëllezërit Poga” SHPK skualifikuar

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Syla” SHPK nga KVO-ja, janë si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik nuk ploteson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht: 2.3.6. Formularin e Ofertës i cili duhet të përmbajë vlerën totale të ofertës pa TVSH dhe me TVSH si dhe elementët e përllëgoartjes së saj. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllëgoartëgt bazuar në:*

*a. Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;*

*b. Elementët fiskal;*

*c. Normën e fitimit e shprehur në % dhe vlerë absolute(lek), e cila duhet të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.*

*Ky operator nuk ka deklaruar sasinë që do të furnizojë dhe çmimin total të ofertes së tij, por ka deklaruar vetëm normën e fitimit. Nuk ka plotësuar saktë Shtojca 2 dhe 3.*

*1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.*

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa më sipër.*

*2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor.*

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa më sipër.*

*3. Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.*

*• Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburantëve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.*

*• Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.*

*• Faqja e menaxhimit të karburantëve (ëebpage) duhet të ofrojë informacion dhe raporte të ndryshme të levrimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.*

*• Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.*

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa më sipër...”*

II.3. Në datën 10.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 14.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6426, protokolluar me nr.845/2026 prot, datë 17.03.2026, i operatorit ekonomik “Syla” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-76447-02-17-2026, me objekt: “Blerje Karburanti për vitin 2026”, me fond limit 7,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Syla” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Me date 09.03.2026 ne oren 17:47 minuta ka ardhë një mesazh në faqen tone të prokurimeve me objekt Refuzim Oferte, si më poshtë

Oferta juaj OFFER-9045/21022026 është refuzuar , pas klikimit të mesazhit shohim se oferta jone është skualifikuar për keto arsye .

1. Operatori Ekonomike nuk ploteson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht 2.3.6. Formulari I ofertes I cili duhet të përmbajë vlerën totale të ofertes pa tvsh dhe me tvsh si dhe elementet e përlllogaritjes së saj . Nuk ka plotësuar saktë shtojcën 2.
2. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e karburantit çdo ditë 24 H sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktore, ky operator nuk ka paraqitur deklaratën sa më sipër .
3. Operatori ekonomike duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryer furnizimin me karte elektornike të personalizuar për çdo automjet të bashkisë Has, ky operator nuk e ka paraqitur këtë deklaratë.
4. Subjekti duhet të deklarojë se e zoteron dhe e mundeson paisjen e AK me sistemin e e menaxhit të faqes së Bashkisë Has, mos ofrimi i këtyre shërbimeve të kërkuara përben shak për skualifikim, ky operator nuk ka paraqitur deklaratën sa më sipër.

Ne piken e para të skualifikimit Autoriteti Kontraktore Bashkia Has, ia ka fut kot dhe kjo është paradoksale .

AK argumenton se nuk paskemi paraqitur oferte të plote, po në fakt oferta paraqitet vetëm në mënyrë që në kemi paraqitur dhe nuk ka mënyrë tjetër kjo ndodh për keto arsye.

Se pari konkurimi ndërmjet operatoreve bëhet në bazë të marzhit të fitimit kjo do të thotë se oferta që në paraqesim për fitim, duke u bazuar në 1 liter nafte pa tvsh dhe me tvsh është oferta e saktë, pasi përlllogaritja sipas bursës është paradoksale në cmim total të ofertes kjo sepse nëse do të llogarisim marzhin e fitimit me cmimin e buresës së botuar në buletin e datës 2 Mars 2026 dhe të shtonin elementet e këtij cmimi duke llogaritur me shtesa Premion, densitetin e produktit, kursin e këmbimit të dollarit ditën e hënë të datës 2 Mars 2026, Akcizën , Taksën e Karbonit , Taksën e Qarkullimit , cmimi i ofertes tone do të plotësohet dhe ky cmim do të shumezohet me litrat e kërkuara nga ana juaj.

*Kjo lloj oferte nuk lejohet pasi cmimi total mund të kalonte edhe vlerën e fondit limit.  
Pra llogaritja bëhet çdo muaj pasi të lidhet kontrata dhe jo në oferte të procedurës së prokurimit, e oferte mjafton vetëm vlera e marzhit të fitimit për 1 liter naftë.  
Sa më sipër Bashkia Has ia ka Fut Kot.*

*Sa i përket pikës 2,3,4 ku pretendoni se po argumentini se nuk kemi shtojcat për deklaratat përkatëse, ju lutem shikojini me vëmendje se janë ato deklaratat dhe jemi në kuader të deklaratave dhe jo në kuader të të provuarit nëse i bëjmë ose jo keto shërbime, pra jemi në kuader të deklaratave,*

*Prandaj nga ana juaj oferta jone duhet të kualifikohet dhe pas kualifikimit nëse do të kishim shkuar të lidhja e kontratës do të lidhej kontrata, dhe pas lidhjes së kontratës Bashkia Has na vendos në dispozicion emrat e secilës karte që duam të personalizojmë, dhe sipas ligjit kemi një afat për të dorëzuar kartat dhe faqet e menaxhit të karburantit, nëse kjo nuk realizohet nga ana jone, bashkia Has cakton përnaltet për Operatorin Ekonomik duke i kërkuar edhe sigurimin e kontratës që të bëjë arketim për Bashkinë Has, dhe anulon procedurën dhe e hedh perseri?.*

*Pra edhe sa i përket këtyre pikave ia kemi fute kot.*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 845/1 Prot., datë 17.03.2026.

II.6. Në datën 27.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.845/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1089 prot., datë 24.03.2026 me objekt: “Kthim përgjigje ankesës për vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për vitin 2026”, drejtuar operatorit ekonomik ankimes dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar kësaj shkrese rezultoi se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

## **Arsyeton**

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Syla” SHPK se: “1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa me sipër.*

2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor.

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa me sipër.*

3. Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.

- Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburantëve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.

- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.

- Faqja e menaxhimit të karburantëve (ëebpage) duhet të ofrojë informacion dhe raporte të ndryshme të levrimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

*Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa me sipër...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.

2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor.

3. *Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.*

- *Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburantëve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.*
- *Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.*
- *Faqja e menaxhimit të karburantëve (ëebpage) duhet të ofrojë informacion dhe raporte të ndryshme të levrimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.*
- *Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Syla” SHPK nuk ka paraqitur asnjë deklaratë që merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu nuk është paraqitur asnjë deklaratë prej tij, referuar kërkesë së AK-së se: *“Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor”* si dhe *“Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit”*.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.4. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet*

*operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. 9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor; Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuarra për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor si dhe Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit, konstatohet se operatori ekonomik “Syla” SHPK, nuk i ka përmbushur këto kritere, pasi në ofertën e tij mungojnë deklaratimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor si më sipër cituar.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se në rast se operatori ekonomik ankimues “Syla” SHPK do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

*“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesave të mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

*“[...]1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e*

*tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]*”

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Syla” SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi ankimuesi nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij subjekti, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Syla” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-76447-02-17-2026, me objekt: “Blerje Karburanti për vitin 2026”, me fond limit 7,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Has.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e finances, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Syla” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

